

VENDIM
Nr.48, datë 28.7.2010

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“DIBRA VIZION”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Sami Neza	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti televiziv privat vendor “Dibra Vizion”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21 dhe nenit 22, 25 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, vendimi nr.848, datë 24.4.2009 i KKRT-së, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VËREN SE:

KKRT, me vendimin nr.232, datë 30.3.2004, ka licencuar personin privat fizik z.Dëfrim Koçi, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor në bashkinë Dibër, për një periudhë prej 5 vjetësh. Në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës, subjekti privat fizik Dëfrim Koçi ka depozituar në KKRT dokumentacionin përkatës për rinovimin e licencës.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit tërësor të aplikimit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, KKRT, me vendimin nr.848, datë 24.4.2009, vendosi paraprakisht mosrinovimin e licencës për TV “Dibra Vizion”, si rrjedhojë e mosparaqitjes së dokumentit që vërteton pagesën e detyrimeve të sigurimeve shoqërore për personat e siguruar.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbledhjen e tij të radhës të datës 22.12.2009, mori në shqyrtim aplikimin për rinovim licence të subjektit “TV Dibra Vizion”. Nga shqyrtimi i aplikimit rezultoi se ky subjekt nuk kishte depozituar ekstraktin e QKR-së. Për këtë arsye, KKRT vendosi që subjekti të njoftohet për të plotësuar mangësinë e konstatuar, duke i lënë në dispozicion një afat të caktuar.

Në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregulloren “Mbi rilicencimin e operatorëve radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së dhe urdhrin nr.35 të kryetarit të KKRT-së, më datë 22.2.2010, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit konstatoi se subjekti kishte paraqitur ekstraktin e QKR-së.

Nga shqyrtimi i ekstraktit të QKR-së, rezulton se pronar i TV “Dibra Vizion” është bërë subjekti privat fizik Hajri Hoxha. Me vendimin nr.232, datë 30.3.2004, për televizionin privat vendor “Dibra Vizion”, KKRT ka licencuar personin privat fizik z.Dëfrim Koçi për një periudhë prej 5 vjetësh. Edhe aplikimi për rinovimin e licencës për TV “Dibra Vizion”, si dhe plotësimet e kërkuara sipas vendimit nr.848, datë 24.4.2009 të KKRT-së, janë paraqitur nga subjekti Dëfrim Koçi, ndërsa depozitimi i ekstraktit të QKR-së, i kërkuar nga KKRT-ja në mbledhjen e datës

22.12.2009, është paraqitur nga subjekti Hajri Hoxha.

KKRT konstaton se, nga ana e subjektit televiziv privat vendor “TV Dibra Vizion” nuk është respektuar neni 22 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, i ndryshuar, sipas të cilit “Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë...”. Gjithashtu, KKRT vëren se nga “TV Dibra Vizion” nuk është respektuar neni 30 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, pasi subjekti nuk ka paraqitur asnjë arsye që të justifikojë ndryshimin e të dhënave, e konkretisht të kalimit të pronësisë nga z.Dëfrim Koçi tek subjekti privat fizik z.Hajri Hoxha. Nga ana tjetër, nga shqyrtimi tërësor i aplikimit për rinovimin e licencës, rezulton se subjekti “TV Dibra Vizion” nuk ka depozituar pranë KKRT-së bilancin financiar për vitin 2007.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22, 25 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.848, datë 24.4.2009 të KKRT-së, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, si dhe të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.066/TVL, të subjektit televiziv privat vendor “TV Dibra Vizion”.
 2. Licenca me nr.066/TVL bëhet e pavlefshme.
 3. Subjekti, sipas pikës 1, të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati